

EXTERNAL VACANCY ANNOUNCEMENT



Tirana International Airport SHPK ("TIA") kërkon të punësojë:

MEKANIKI/ XHENERIKI/ MOTORIST

i cili do të raportojë tek Përgjegjës i Oficinës.

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë e pozicionit:

- Bën kontrollin ditor të gjendjes teknike të mjeteve që operojnë në V.Q.A. Merr udhëzimet paraprake për veprimet që mund të kryejë.
- Raporton tek drejtori i departamentit për gjendjen teknike të mjeteve.
- Kontrollon që gjëndja teknike e mjeteve është në kushte normale mekanike dhe parametrat janë optimal.
- Kontrollon me imtësi gjendjen e sistemit të ushqimit të mjeteve.
- Kontrollon gjendjen e mjeteve dhe bën provën e ndezjes së tyre në mënyrë që të jenë në gadishmëri për punë.
- Për çdo anomali të konstatuar mban shënimet përkatëse dhe i raporton shefit I departamentit.
- Kryen shërbimet e planifikuara në planin e punës të përgatitur nga departamenti mekanik dhe raporton për zbatimin e tyre.
- Merr pjesë aktive në eliminimin e defekteve të ndryshme në sistemin e ushqimit, në hapjen e motorrit, në heqjen e testates, në riparimin e pjesëve të brendshme të motorrit, në kryerjen e proves finale për punë.
- Nuk largohet nga vendi i punës gjatë gjithë orarit të punës, në rast nevojë duhet të njoftojë menaxherin e departamentit i cili merr masa për zëvendësimin e tij.
- Kontrollon me imtësi gjendjen e sistemit të frenimit, hidraulik dhe mekanik.
- Është përgjegjës për sigurinë teknike dhe zbatimin e saj gjatë gjithë punimeve të ndryshme.

Aftësitë e kërkuara:

- Preferohet Diplomë Universiteti
- Preferohet përvojë e meparshme në pozicione të ngjashme
- Saktësi dhe aftësi për kryerjen e kontrollit / inspektimit
- Aftësia për të ndjekur në mënyrë strikte udhëzimet e Eprorëve
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive si pjesë e një ekipi
- Aftësi për të punuar nën stres dhe përgjigjen ndaj emergjencave

Për të aplikuar për këtë pozicion aplikantët duhet të plotësojnë Formularin e Aplikimit, i cili mund të gjendet tek faqja e internetit: www.tirana-airport.com dhe të dërgohet me postë elektronike së bashku me një CV të përditësuar në adresën: human-resources@tirana-airport.com

Departamenti i Burimeve Njerëzore do të kontaktojë për intervistë vetëm aplikantët e kualifikuar.